



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

## GJYKATA THEMELORE PEJË

---

AD/GJTHPE/.nr.2/23

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË**, me Kryetarin e Gjykatës Armend Berisha, në procedurën disiplinore ndaj gjyqtarit I.B, duke vepruar sipas ankesës disiplinore të parashtruar nga avokati J.J, “Rr. e D.” nr., O., si i autorizuar i D.A, nga Peja, pas shikimit të shkresave dhe vlerësimit të ankesës, jashtë seancës, me datë 23.02.2023, mori këtë:

### A K T V E N D I M

**REFUZOHET** ankesa disiplinore e parashtruar nga avokati J.J si i autorizuar i D.A, ndaj gjyqtarit I.B, **SI E PABAZUAR.**

### A r s y e t i m

Me datë 25.01.2023, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, duke vepruar konform nenit 9 par.2 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, ka përcjellë ankesën disiplinore të parashtruar nga avokati J.J, “Rr. e D.” nr., O., si i autorizuar i D.A, ndaj gjyqtarit I.B, me arsyetimin se në lëndën C.nr.494/17, gjyqtari ka marrë Aktvendimin e datës 15.11.2021, me të cilin ka ndërprerë procedurën në këtë çështje për shkak të vdekjes së të paditurit të dytë I.Z, nga Prishtina, të cilin vendim e konsiderojnë të kundërligjshëm sepse i padituri i parë është gjallë dhe është plotësisht i aftë që të marrë pjesë në procedurën e mëtejme pavarësisht faktit se i padituri i dytë ka vdekur gjithashtu, i njejtë me Aktvendim ka caktuar vlerën e kontestit duke mos marrë parasysh precizimin e kërkesëpadiisë së dorëzuar nga paditësit si dhe nuk i ka njoftuar paditësit dhe përfaqësuesin e tyre ligjorë lidhur me vendimin, me çka vlerësojnë se gjyqtari B. ka kryer shkelje disiplinore nga neni 5 par.2 pika 2.1 i Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, pasi është marrë vendim duke u bazuar në paragjykimet fetare dhe kombësisë serbe të paditësve. Andaj, i ka propozuar autoritetit kompetent që të ndërmarrë veprime ligjore dhe të nisë procedurën për vërtetimin e përgjegjësisë disiplinore ndaj gjyqtarit I.B.

Me datë 03.02.2023, Kryetari i Gjykatës duke vepruar në kuptim të nenit 9 par.5 të Ligjit mbi Përgjegjësitë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve e ka njoftuar Këshillin Gjyqësor të Kosovës për pranimin e ankesës disiplinore të parashtruar nga avokati J.J si i autorizuar i D.A, ndaj gjyqtarit I.B.

Gjyqtari I.B, në deklaratën e tij të dhënë me shkrim lidhur me pretendimet e parashtruesit të ankesës, ka deklaruar se lëndën në fjalë e ka pranuar pas përjashtimit të gjyqtares së mëparshme dhe sapo e ka pranuar në punë, ka filluar procedurën ashtu që lënda ka qenë në rrugë e sipër për të marrë epilog përkundër veprimeve destruktive dhe përpjekjeve të vazhdueshme të palës së paditur për prolongim të procedurës. Lidhur me ndërprerjen e procedurës, gjyqtari ka sqaruar se ka vepruar konform nenit 227 të LPK-së, pasi i padituri kishte vdekur dhe se në Aktvendimin për ndërprerjen e procedurës, palën paditëse e ka njoftuar me të drejtën për të kërkuar vazhdimin e procedurës ndaj trashëgimtarëve të të njëjtit dhe se a ka vepruar konform ligjit apo jo, këtë mund ta thoshte vetëm gjykata e shkallës së dytë,

e cila ka juridiksion të bëjë vlerësimin dhe kontrollin e ligjshmërisë së vendimeve që i merr, të drejtë kjo të cilën pala paditëse nuk e ka shfrytëzuar përkundër mundësisë që ka pasur pasi që aktvendimi përmban këshillën juridike mbi të drejtën e palëve për ankesë, e drejtë kjo që nuk është shfrytëzuar nga pala paditëse. Gjithashtu, gjyqtari ka sqaruar se Aktvendimi mbi ndërprerjen e procedurës i është ekspeduar të autorizuarit të palës paditëse pra, paditësja ka qenë e përfaqësuar nga një profesionist dhe ka pas mundësi që mbi bazën e ankesës të vlerësoj ligjshmërinë e vendimit mbi ndërprerjen e procedurës dhe se palën paditëse askush nuk e ka ndaluar që të kërkojë vazhdimin e procedurës ndaj trashëgimtarëve të të ndjerit I. Z apo edhe vetëm ndaj të paditurit. Pretendimet e tjera të parashtruesit të ankesës, gjyqtari thekson se janë të pabazuara respektivisht, të paargumentuara andaj, mbi bazën e të lartcekurave ka propozuar që ankesa disiplinore të refuzohet si e pabazuar pasi vlerëson se në veprimet e tij në këtë çështje nuk ekziston asnjë element i shkeljeve disiplinore të etikës për gjyqtar.

Kryetari i Gjykatës duke vlerësuar ankesën e parashtruar ndaj gjyqtarit I.B, së bashku me deklaratën e tij, ka gjetur se ankesa disiplinore është e pabazuar meqë, arsyet mbi të cilat është mbështetë ankesa disiplinore janë pretendime ankimore, të cilat janë objekt vlerësimi i gjykatës së shkallës së dytë dhe të njëjtat nuk hyjnë në domenin e shkeljeve të natyrës disiplinore të përcaktuara në mënyrë taksative me nenin 5 par.1 dhe 2 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Ndërsa, pretendimi se gjyqtari I.B në çështjen juridiko civile C.nr.494/17, ka nxjerrë vendime duke u bazuar në paragjykimet fetare dhe kombësisë serbe të paditësve, me çka ka kryer shkelje disiplinore nga neni 5 par.2 pika 2.1 i Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, sipas së cilit gjyqtari kryen shkelje disiplinore nëse, “2.1. kryen detyra zyrtare duke mos respektuar parimin e pavarësisë dhe paanshmërisë gjyqësore duke vepruar me paragjykime në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike dhe sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal të palës në procedurë;”, është pretendim tërësisht i paargumentuar dhe i pambështetur në asnjë provë.

Andaj, nga arsyet e theksuara me lartë, konform dispozitave ligjore të nenit 9 par.6 të Ligjit mbi Përgjegjësitë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenin 7 par.3 pika 3.2 të Rregullores të Këshillit Gjyqësor të Kosovës nr.05/2019 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## **GJYKATA THEMELORE NË PEJË - AD/GJTHPE/.nr.2/23, me datë 23.02.2023**

**Kryetari i Gjykatës**

---

**Armend Berisha**

*Vendimi i dorëzohet:*

- 1. Këshillit Gjyqësor të Kosovës*
- 2. Gjyqtarit I.B*
- 3. Parashtruesit të ankesës – J.J, avokat*